



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 15/15

Prishtinë, më 22.4.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjona, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Ilir Deda, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Bojan Mitić.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Ministër i Financave, Ruzhdi Jashari – Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror në ASHMDHP, Bujar Sadiku – Drejtor në ASHMDHP, Enver Halimi – Kryesues i Bordit në ZRRE, Ejup Hasolli – Zyrtar Kryesor Financiar në ZRRE, Bahrije Berisha – Zv. Kryesuese në ANJF, Ramadan Gashi – Drejtor Ekzekutiv.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Alexandra Fehlinger, Ramadan Islami, dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga Zyra e Presidencës, Gazetar nga KosovaPress, Gazetar nga RTK.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Zyrës Rregullative për Energji për vitin 2014;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit financiar i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2014;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – njoftoj se në të ndryshme do të ketë një njoftim nga Alexandra Fehlinger për evaluimi e projektit të GIZ-it dhe një njoftim lidhur me punën e grupit punues për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës. Po ashtu do të caktohet edhe grupi punues i cili do të merret me hartimin e Ligjit për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, sipas planit dhe programit të punës.

Me pas kryetari konstaton se komisioni njëllojë miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014

Kryetari – njoftoj se raporti financiar vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014 është dorëzuar në Kuvend në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit. Raporti pasqyron të dhënat për realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve totale, krahasimin e tyre me planin buxhetor dhe vitet paraprake. Po ashtu raporti përmban të dhëna për llojin e të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara, përfshirë të hyrat nga doganat dhe ATK, të hyrat vetanake të komunave dhe të hyrat e nivelit qendror, grantet e pranuara nga donatorët, huazimet e jashtme dhe të brendshme dhe të hyrat sipas burimeve të caktuara. Po ashtu raporti prezanton edhe nivelin e deficitit, në raport me GDP-në. Të hyrat janë në shumë prej 1,462,579,000 euro (1.2% ose 17,414,000 euro më shume se viti 2013), ndërkaq shpenzimet në shumë prej 1,510,856,000 euro (-0.046% ose -702,000 më pak se viti 2013).

Avdullah Hoti – sqaroj se raporti është në përputhje me kërkesat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike. Plani vjetor i pranimeve për 2014 ka qenë 1,641,545,000 euro dhe plani vjetor i pagesave ka qenë 1,655,921,000 euro, përfshirë edhe të hyrat e bartura nga viti 2013. Të hyrat gjatë vitit 2014, duke mos përfshirë pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe Fondi i depozitave në mirëbesim kanë qenë 1,448,957,000 euro dhe paraqesin 88.3% e të hyrave të përgjithshme vjetore të planifikuara. Të hyrat e mbledhura nga dogana kanë arritur në vlerë prej 871,000,000 euro që është rreth 93% e planit vjetor. Në Administratën Tatimore janë inkasuar 303,700,000 euro apo 83% e planit vjetor. Kthimi i TVSH-së nga ATK-ja dhe Dogana janë në vlerë prej 2.4 milion euro dhe 31.1 milion euro, respektivisht. Të hyrat jo tatimore kanë qenë 47.4 milion euro ose rreth 99% e planit vjetor. Të hyrat vetanake të nivelit qendror kanë arritur në 36.5 milion që është 73% e planit vjetor. Të hyrat vetanake të komunave kanë arritur në vlerë prej 61 milion euro apo 91% e planit vjetor. Nga 38 komuna, 36 prej tyre kanë realizuar të hyra më shumë se në vitin paraprak, ndërkaq vetëm Prishtina dhe Graçanica kanë arritur të realizojnë të hyra më pak se në vitin paraprak. Të hyrat nga taksa koncensionare janë 5.3 milion euro, nga tantiemat 26.5 milion euro, të hyrat e dedikuara të AKP-së janë 2.3 milion euro, dhe të hyrat nga devida janë 15 milion euro. Ne kemi pas huazimit nga Institucionet Financiar Ndërkombëtar në vlerë prej 9.3 milion euro dhe kemi pas pranime nga letrat me vlerë prej 104 milion euro që është 87% e planit vjetor.

Sa i përket shpenzimeve, niveli i ekzekutimit të pagesave ka qenë 90% krahasuar me planin. Për paga dhe rroga janë shpenzuar 32% e buxhetit që është në total 485.2 milion euro. Për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 183.7 milion euro. Shpenzimet Komunale janë 1% e shpenzimeve të përgjithshme që është 22.1 milion euro ose 87% e planit vjetor. Për subvencione dhe transfere janë shpenzuar 24% e shpenzimeve totale në vlerë 361.2 milion euro. Përveç asistencës sociale dhe ndihmave tjera, subvencionet dhe transferet për KEK-un janë shpenzuar 1.6 milion euro, për importin e energjisë për raste sociale 4.5 milion euro, për ngrohje qendrore 3.5 milion euro, për ujë dhe mbeturina 0.6 milion euro, miniera e Trepçës 3.1 milion euro, Trankos 0.5 milion euro, Infrakos 0.6 milion, dhe RTK-në 9.3 milion euro. Shpenzimet kapitale marrin pjesë prej 27% të shpenzimeve totale, që në vlerë absolute është 411.4 milion euro ose rreth 80% e planit vjetor. Ndërkaq shpenzimet për servisim të borqeve kanë qenë 34.9 milion apo 9% e planit vjetor.

Kemi pas edhe të hyra të donatorëve gjatë vitit 2014 në vlere prej 13.8 milion euro dhe gjendja e fondeve në fund të viti 2014 është 163.5 milion euro. Përveç kësaj në Raport kemi prezantuar edhe të dhëna dhe vlerësime tjera për mënyrën e menaxhimit dhe performimit të financave publike për vitin 2014 dhe vështirësitë që janë paraqitur. Kemi vërejtur që shumë organizata buxhetore kanë pas vonesa në ekzekutimin e kontratave dhe kanë pas probleme me zotimin e mjeteve dhe si rezultat kemi nënshpenzim në shumicën e projekteve kapitale. Ka rritje të pagesave për shkak të vendimit të gjykatave kur organizatat e caktuara buxhetore nuk i kanë përfillur të gjitha procedurat sa i përket respektimit të kontratave dhe si rezultat është përmbyllur viti me një shumë të konsiderueshme të borxhit të organizatave buxhetore të cilat ne tash kem filluar ti akomodojmë me buxhetin për vitin 2015. Në janar i kemi kërkuar që të bëjnë përmirësimet e duhura në tabelat buxhetor të organizatave përkatëse. Shumë pak organizata buxhetore iu kanë përgjigjur kësaj kërkesë dhe tani ne kemi filluar të

ekzekutojmë faturat që vijnë për borxhin e vitit paraprak nga buxheti i këtij viti të atyre organizatave në përputhje me kompetencat që ne i kemi si ministri e financave. Kemi filluar me marr masa që këto probleme të mos paraqiten ende sepse problemet kanë ardhur si rezultat i fillimit proceduarave tenderuese për projekte të ndryshme pa pas zotim mjeteve dhe pa qenë të reflektuar projekti në buxhet.

Kryetari – sa i përket deficitit buxhetor në bazë të të dhënave është në shumë prej 122,479,000 euro, del se është 2.2% dhe kemi një tejkalim të rregullës fiskale për 0.2%.

Avdullah Hoti – sa i përket deficitit në jemi brenda rregullës fiskale. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike thotë që rregulla fiskale thyhet në rast se deficitit për dy vit rresht tejkalon 0.5% të GDP-së. Pra maksimumi i deficitit që këtë vit mund të lejojmë për të mos thyer rregullën fiskale është 2.19 e GDP-së.

Enver Hoti – tek subvencionet dhe transferet po vërehet se është mbështetur KEK-u dhe RTK-ja me një shumë të konsiderueshme. A do të vazhdojë ende subvencionimi, kur dihet gjendja që aspak e mirë në këto dy institucione. Pra nevojitet arsyetimi i këtyre subvencioneve sepse RTK-ja është një shumë e konsiderueshme prej 9.5 milion euro?

Kryetari – sa i përket financimit të RTK-së, ligji është shumë qartë dhe ajo ka qenë për një fazë tri vjeçare që Qeveria ti mbulon shpenzimet e RTK-së. Tri vjet po bëhen dhe viti i katërt ka me qenë një problem i financimit të RTK-së nëse nuk ndërmerren masa siç janë të përshkruar në ligj.

Besa Gaxherri - në rrjedhën dalëse të parasë së gatshme nga viti 2012 e në vazhdim, pagat dhe rrogat janë në rritje. Në vitin 2012 janë shpenzuar 407 milion, në vitin 2013 417 milion euro dhe në vitin 2014, 485 milion euro, konkretisht pyetja që shtrohet, a është kjo si shkak i rritjes së stafit apo është ajo rritja e 25%? Pastaj, mallrat dhe shërbimet janë 183 milion dhe nëse vërtet i analizojmë mirë këto shpenzime, ne mundemi të bëjmë zbritje deri në 50% në këtë kategori, sidomos kur kemi nevojë. Për shpenzimet kapitale në faqen 25, janë 411.3 milion euro dhe kur e analizojmë mirë del që veç 212 milion janë shpenzime kapitale për ndërtim të rrugëve, tjerat shkojnë në ndërtesa prej 62.260 milion euro? Për energji elektrike, gjenerim dhe transmision 935,000 euro, pajisje të IT-së 28 milion. Te ndërtesat i kemi 62 milion por kur të marrim parasysh fusnotën, e kemi një kapital tjetër 47,282 që del prapë ndërtesa. Pajisje të IT-së 28 milion e kemi prapë në fusnotë shpenzime për IT dhe kjo është një paqartësi. Tek faqja 21 i kemi pagat dhe rrogat dhe punëtorët me kontratë (jo në listën e pagave) janë 436,000 euro, përveç që kemi sqarimin për pagat në rritje, plus e kemi në list të pagave edhe në këtë shumë. Sa i përket taksës administrative më ka lënë përshtypje taksa për çertifikatën e vdekjes që është zero. Qytetarët këtu nuk e bëjnë tërheqjen e çertifikatës të vdekjes dhe kjo është shqetësuese se kemi problem me listat e regjistrimit civil dhe kjo jep sinjal se asnjë takës nuk është mbledh në çertifikatën e vdekjes. Shpenzimet për shërbime, në fusnotë përzihen shpenzimet e udhëtimit dhe veç janë ndarë për tu emërtuar. Shpenzimet për shërbime janë 41,156,000 euro, mobile dhe pajisje 6,321,000 euro, derivate dhe lëndë djegëse 22,192,000 euro, që konsiderojë se janë pak shumë. Shpenzimet e përfaqësimit nuk e di se çka janë dhe janë shpenzuar 3,220,000 euro. Investimet kapitale janë të paqarta dhe figurojnë 411 milion, dhe nuk janë shpenzuar as gjysma e këtyre mjeteve. Në të ardhmen kemi punë për ti orientuar mjetet tek investimet kapitale sepse shpenzimet kryesisht shkojnë tek mallrat dhe shërbimet dhe te pagat. Po ashtu duhet përmendur zyrtarisht borxhin publik që të jemi të informuar sa është për vitin 2014?

Safete Hadergjona – nëse analizojmë këtë raport të shpenzimeve me raportet e viteve të kaluara , vërehet se për çdo vit po përmirësohen kapacitetet planifikuese të buxhetit dhe ka një realizim më të mirë të buxhetit. Po ashtu vërehet se janë zvogëluar shpenzimet për mallra dhe shërbime. Kurse disa shqetësime të cilat janë ngritur në lidhje me shpenzimet kapitale ndoshta është mirë që të kemi një sqarim në lidhje me këto çështje. Shpenzimet e mëdha të IT-së në vitin e kaluar do të ndikojnë që gjatë planifikimit buxhetor, për IT të transferohen mjetet me rastin e miratimit të buxhetit në vitin 2016. Gjatë këtij viti nuk kemi pas rishikim të buxhetit dhe këtu tek Aneksi 1 ku gjindet krahasimi për ndarjet

buxhetore pothuajse të gjitha institucionet sidomos komuna po edhe ministrit dhe institucionet e pavarura, kanë një ndryshim nga buxheti fillestar me ndarjet buxhetore dhe secila organizatë buxhetore ka të tejkaluar buxhetin, si për shembull Prishtina 129% nga ajo që është planifikuar. Si ka ardhur deri te kjo rritje e tillë kur ne nuk kemi pas rishikim të buxhetit që me lëviz pozicionet nga buxheti i planifikuar në ato të realizuar. Apo ka qenë rritja e pagave si shkak të kësaj rritje apo si qëndron çështja në këtë drejtim?

Bali Muharremaj – tek subvencionet dhe transferet, si ka mundësi që qytetarët të paguajnë dy herë, si për shembull paguhet rryma dy herë, kur dihet që paratë marren tatimpaguesit dhe këto shpenzime paguhen nga buxheti i shtetit? Po ashtu shpenzimet për nxemje janë shuma të mëdha. Në këtë vit është bërë një ekspertizë në një shkollë të Prizrenit, dhe në qoftë se në vitin paraprak janë shpenzuar 12,000 euro në lëndë djegëse këtë vit i kanë shpenzuar në thënxhill 6,000 euro. Pse nuk shfrytëzohen burimet e brendshme në këtë drejtim. Po ashtu për buxhetin e Radiotelevizionit kërkohet një sqarim?

Kryetari – vërejtjet që po bëhen në shpenzime të energjisë kanë të drejtë për arsye se ndoshta edhe ligjet janë shkak po edhe mos fleksibiliteti i jonë për të përdorur edhe mundësitë tjera për energji alternative. Ndoshta duhet ndryshuar edhe qasja e sigurimit të energjisë, që përpos mundësive që ofron KEK-u, edhe qeveria duhet stimuluar këtë energjinë alternative.

Avdullah Hoti – unë do të kërkoj të dhëna mbi çfarë vendimi i është dhënë KEK-ut shuma 1.6 milion euro. Kjo nuk ka qenë e reflektuar as në buxhet, një ndarje buxhetore për këtë qëllim. Sa i përket RTK-së i kemi shpenzuar 9.3 milion euro në subvencione në bazë të ligjit të buxhetit. Unë besoj që do të këtë një zgjidhje që nga viti 2016 për financimin e RTK-së, pasi që jemi duke e finalizuar KASH-in dhe nuk kemi paraparë subvencionim për RTK-në. Tek pagat, rritja shumë e madhe është si rezultat i vendimit për rritje të pagave prej 25% në vitin e kaluar. Tek kapitalet edhe unë kam vërejtje për mënyrën se si janë prezantuar të dhënat dhe informata më detale mund t'iu ofrojmë. Paisjet e IT-së, po ju them se nuk është një shumë e madhe sepse ne po shkojmë drejt informatizimit të plotë të sektorit publik. Në fillim të prezantimit kam thënë se vërejtja kryesore këtu është se shumë organizata buxhetore nuk i përfillin kodet buxhetore dhe si për shembull marrin buxhetin prej projektit A që mund të jetë për ndërtim të shkollës dhe vendosin mjetet në projektin B që është për ndërtim të rrugës. Po ashtu ka pas lëvizje nga mallrat dhe shërbime në investime kapitale për shkak shkurtimit të buxhetit në mallra dhe shërbime në vitin e kaluar. Pagesat për pagat që janë paguar jashtë listës së pagave sipas vendimeve për punësim në afat të shkurtër me kontratë, organizatat buxhetore kanë drejtë ti bëjnë dy herë nga tre muaj. Ka plotë që e kanë tejkaluar atë, mirëpo është baza ligjore që kur paraqitet detyra, sidomos gjatë verës vijnë emigrantet dhe komunat duhet të punësojnë staf shtesë për të ofruar dokumentacion për mërgimtarët. Pyetja për Aneks është çështja e rritjes së pagës për 25% dhe zvogëlimi në mallra dhe shërbime për 15% dhe kjo e ka bërë ndryshimin. Tek shpenzimet e mëdha për nxemje keni plotësisht të drejtë, prandaj në këtë vit kemi filluar kredinë me Bankën Botërore për efikasitet të energjisë, për izolim më të mirë të ndërtesave publike dhe shkollave në mënyrë që të ruhet energjia. Borxhi publik është rreth 10.5% të GDP-së dhe në bisedat që kam pas në Washington ky mund të rritet edhe për 10%, për të mbështetur projektet.

Bali Muharremaj – sa janë borxhet kontraktuale për organizatat buxhetore për vitin 2014? Si ka mundësi ministria e zhvillimi ekonomik, për shembull me ndarjen mjete për kompanitë publike siç janë kompanitë e ujësjellësit, mbeturinave, kur dihet se këto kompani marrin mjete prej taksapaguesve, dmth., po bëhen pagesa dy herë. Pra, këto kompani edhe po marrin mjete nga qytetarët me rastin e pagesës së shërbimeve, por edhe po financohen nga buxheti i Kosovës.

Avdullah Hoti – janë disa ndërmarrje publike që janë të rëndësishme kapitale për jetën e qytetarëve, si për shembull furnizimi për energji, furnizimi për ujë dhe mbeturina, në rast se këto ndërmarrje kanë vështësi financiare dhe nuk kanë mjete për të përformuar nuk mundemi ti mbyllim dhe duhet

subvencionuar në afat të shkurtër. Në afat të gjatë po punojmë me Komisionin ndërmarrës për zhvillim ekonomik që të vendosim indikatorët e performancës për secilën ndërmarrje. Obligimet që janë në Aneksin 9 janë vërtet shqetësuese dhe këtë e kam biseduar edhe në Qeveri dhe kemi marrë masa tash, dhe asnjë organizatë buxhetore nuk mund të krijoj shpenzime në rast se nuk janë të reflektuar në buxhet. Asnjë tender nuk mund të hapet nga KRPP nëse nuk merret miratimi i projektit prej thesarit dhe prej buxhetit që ka mjete për zotim.

+6

Enver Hoti – organizatat buxhetore po gjejnë mënyra të punësimit, për shembull menaxherët e tyre punësojnë njerëzit për shkak të premtimeve e jo për shkak se ju duhen punëtorët. Mendojë që janë ngritur kapacitetet dhe burimet njerëzore në çdo institucion, dhe mund ti përballojnë edhe flukset që ju i referuat gjatë verës kur mund të ketë shërbime shtesë. Duhet të rishikohen mundësit ligjore dhe të kufizohen këto shpenzime, se me mjetet e tilla do të mund të realizohen projekte të rëndësishme.

Kryetari – konsideroj që raporti është i mirë dhe i mjaftueshëm për tu kuptuar dhe për të dhënë informacionet lidhur me shpenzimet. Ne si komision, siç e kemi paraparë plan të punës, për herë të parë do të fillojmë të marrim informata të drejtpërdrejta nga ATK dhe Dogana në baza tre mujore, në mënyrë që të jemi të informuar me ecurinë e realizimit të planifikimit në këto dy institucione që janë kryesore për inkasimin e të hyrave buxhetore. Ky është një raport i paraqitur nga Qeveria dhe ne e konsiderojmë që të dhënat janë të sakta. Do të ketë edhe një raport vjetor të auditorit të përgjithshëm në të cilin mund të informohemi me të gjitha të gjeturat në shpenzime.

Safete Hadergjona - raportit financiar është mirë që ti bashkangjitet një raport shtesë me informata për shpenzimet e investimeve kapitale, për të parë planifikimin dhe realizimin e këtyre shpenzimeve dhe rrjedhën e tyre gjatë vitit të kaluar, me qenë se fokusi i jonë dhe i deputetëve është pikërisht tek realizimi i investimeve kapitale. Një pyetje tjerë, a është rregulluar sistemi sepse kemi pas vërshim të komunave dhe të njerëzve për pagesa, që për një periudhë të kohës, kanë qenë të bllokuara dhe a do të ketë më probleme në këtë drejtim, sepse ka pas shqetësime për arsye se borxhlinjtë kanë filluar të bëjnë presion nëpër komuna të ndryshme?

Besa Gaxherri – sa i përket të hyrave vetanake të komunave, nëse e bëjmë krahasimin e komunave, vërejmë që disa komuna kanë një trend të rritjes që nga viti 2012. Në të kundërtën që është zhgënjyes sidomos Prishtina që prej vitit 2012 deri 2014, nga 23 milion ka rënë në 19 milion euro. Ndoshta është dashur, ju si ministri të bëni një analizë dhe me të bëni një rregull që ato komuna të cilat arrijnë një shumë më të madhe të inkasimit të të hyrave vetanake, t'iu mundësoni që ato të kenë prioritet për subvencione. Për arsye se disa komuna ose kryetar të komunave nuk ju intereson fare me punë që ti mbledhin të hyrat vetanake sepse kanë lidhje në ministri dhe marrin subvencione dhe kryen punë. Ndërsa disa të tjera janë të rregullta në inkasim dhe mendoj se ata duhet të kenë përparësi në shpërbllim.

Avdullah Hoti – ne do ta sjellim listën e plotë të projekteve kapitale që kanë qenë të parapara për vitin 2014 dhe sa është shpenzuar në secilin projekt brenda dy-tri ditësh në mënyrë që ti bashkangjiten raportit për Kuvend, dhe këtë e bëjmë praktik të rregullt. Tek shpenzimet për vitin 2015 mund të ketë shumë ankesa por asnjë problem teknik nuk është. Problemi qëndron tek planifikimi i organizatave buxhetore. Në javët e para të janarit unë i pyes secilën organizatë buxhetore të sjellin rrjedhën e parasë për gjithë vitin dhe nëse ata kanë planifikuar që të shpenzojnë nga 2 milion secilin muaj, nuk mund të sjellin pagesa më shumë se 2 milion për atë muaj. Problemi vjen edhe nga obligimet e vitit të kaluar. Sa i përket inkasimit të të hyrave vetanake të komunave, tek granti i përgjithshëm këtë vit jemi duke e zhvilluar skemën dhe duke e bërë vlerësimin e performancës të secilës komunë dhe mundësit e tyre për të inkasuar të hyra në mënyrë që të vlerësojmë në bazë të aktivitetit biznesor, numrin e bizneseve, numrin e qytetarëve dhe të ardhura mesatare, që të dimë se secila komunë sa mund të mbledh. Pastaj granti i përgjithshëm që i ndahet komunave të jetë i lidhur me potencialin për të mbledhur të hyrat nga secila komunë se ka një mosbarazim në këtë drejtim. Për Prishtinën të hyrat janë pak shqetësuese, janë

ndërprerë aktivitetet biznesore, sidomos tek ndërtimi dhe rishikimi i lejeve ka afektuar edhe biznesin privat, të hyrat vetanake të komunave dhe buxhetin e Kosovës.

Bardhyl Meta – te tantiemat është e mirë shifra e të hyrave prej 26 milion euro dhe kishte me qenë mirë që ti kemi detajet për këtë.

Kryetari – propozojë që rekomandimi i Komisionit në Kuvend, të jetë për aprovim të raportit të shpenzimeve për vitin 2014, me premtimin e ministrit që raportit ti bashkangjitet edhe lista e investimeve kapitale, që do të dërgohet nga ministria e financave, brenda tri ditëve.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratohet Raporti financiar vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014

Kryetari – në bazë të nenit 44, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-172, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ka paraqitur raportin vjetor Kuvendit të Kosovës. Raporti vjetor financiar i Agjencisë është hartuar sipas formularëve standard. Agjencia për vitin 2014 ka pasur buxhetin final të ndarë në vlerë prej 396,000.00 euro dhe pas shkurtimit prej 24,300.00 euro, buxheti përfundimtar i shpenzuar është 369,681.57 euro.

Ruzhdi Jashari – sa i përket aspektit buxhetor Agjencia ka operuar me një buxhet prej 396,000.00 euro, janë mbet për operim 371,700 dhe kemi shpenzuar 369,681.57 euro. Nga këto, për paga dhe mëditje janë shpenzuar 183,567.36 euro ose 99.76%, mallra dhe shërbime 132,737.97 ose 99.77%, shpenzime komunale 3,486.24 euro ose 74.81%, dhe shpenzimet kapitale janë 49,890 euro ose 99.78%. Një nga sfidat që kemi pas fillimisht në vitin 2011 deri në vitin 2013 ka qenë aspekti i vendosjes në objekte shtetërore.

Kryetari – ku gjinden tani me zyre?

Ruzhdi Jashari - jemi në mes të kompleksit të ministrisë së punës së jashtme. Sa i përket aspekteve të përmbushjes së detyrimeve të rekomandimeve të auditorit të jashtëm, nga 8 rekomandimet, kemi mbërrirë me i eliminuar të gjitha e jemi me 3 rekomandime në proces. Një çështje tjetër është bashkëpunimi që ka Agjencia me agjencitë homologe të vendeve të ndryshme. Agjencia është anëtare më drejta të plota e të barabarta në organizatën për çështjet e inspektimeve. Jemi në pritje të organizimit të konferencës ndërkombëtare, që paraprakisht kemi biseduar me kryetarin e komisionit për buxhet, ministrin e financave edhe me kryeministrin, për mbështetjen edhe financiare të organizimit të këtij eventit ndërkombëtar.

Besa Gaxherri - kam analizuar raportin financiar dhe mendoj se duhet dhënë sqarime për shpenzimet, sidomos në mallra dhe shërbime. Shpenzimet e udhëtimit janë gjithsej 26,368 euro dhe në kuadër të këtyre shpenzimeve, hyjnë shpenzimet e udhëtimit 5,000 euro, mëditjet e udhëtimit jashtë vendit 11,000 euro, për udhëtimet jashtë vendit 7,000 euro dhe udhëtimet zyrtare 3,000 euro, për të gjitha këto kërkohet të na jepni sqarime. Një shpenzim tjetër që më ka tërhequr vëmendjen janë shpenzimet e telefonisë mobile që janë 4,194 euro, 1,680 euro keni blerë telefona dhe 2,484 euro shpenzimet të

telefonisë fikse dhe në total këto shpenzime janë rreth 10,000 euro. Shërbimet e arsimit dhe trajnimit janë 2,770 euro, por prapë keni kodin tjetër shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse 12,545 euro. Shërbimet kontraktuese janë 11,000 euro, dhe nuk ka sqarime se çfarë janë këto shpenzime. Sa i përket investimeve kapitale, në vitin 2013 i keni harxhuar 43,359 euro në vetura, ndërsa po ashtu në vitin 2014, 50,000 euro i keni shpenzuar në blerjen e veturave, ndërkaq 5,350 euro janë për mirëmbajtje të veturave. Për të gjitha këto është e nevojshme të jepni sqarime. Po ashtu sqarime janë të nevojshme për shpenzimet për mirëmbajtjen e teknologjisë informative prej 5,000 euro dhe mirëmbajtja e paisjeve të mobileve prej 1,700 euro.

Bali Muharremaj - në bazë të analizës që i kam bërë raportit, mundem me vlerësues një raport të mirë, ka përparime dhe disa gabime të vogla. Ndërkaq pasqyrat e audituara financiare, shqyrtohen më detalisht në komisionin për mbikëqyrjen e financave publike, kur të dërgohet raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Ilir Deda – nga të dhënat në raport, shihet se shpenzimet për shërbime intelektuale janë tejkaluar mbi 600%, nga ajo që është planifikuar, ndërsa shpenzimet për trajnime apo aftësime, që janë shumë më rëndësi për agjencionin tuaj, janë shpenzuar vetëm 23%, pse ka ardhur deri te kjo shpërputhje? Për këtë vit a keni ndërmend të rrisin kapacitetet për trajnime dhe aftësim të kudrave, që do të thotë më pak ndihmë nga jashtë?

Ruzhdi Jashari – është e rëndësishme që zërat kryesorë janë në përputhje me ligjin. Ndërsa për tejkalimin e disa nënkategorive, kanë ndikuar disa aspekte për me bërë një lëvizshmëri. Vitin e kaluar kemi pas një kërkesë për rishqyrtimin buxhetor, që nuk ka pasur, dhe ne detyrimisht në disa nënzëra kemi pasur lëvizje buxhetore. Sa i përket shpenzimeve kapitale, ne punën e bëjmë në terren dhe për këtë arsye janë këto shpenzime për veturat.

Bujar Sadiku - çdo tejkalim i nënkodeve, pavarësisht që nuk rregullohet për momentin me legjislacionin sekondar ato janë arsyetuar me vendime të cilat janë nxjerr nga Këshilli i Agjencisë. Sa i përket shpenzimeve të mobileve, ne kemi pas edhe shpenzime të vitit 2013, te cilat na kanë tërheq dy fatura të vitit 2013 dhe 2014 dhe prandaj është krijuar gjendja prej 4,194 euro. Shpenzimet e telefonisë mobile pavarësisht që planifikimi ka qenë shumë i lartë, shpenzimet kanë qenë shumë më të ulëta. Ne i kemi ulur në vazhdimësi këto shpenzime, por fakturat e muajit nëntor dhe dhjetor dhe kanë dal 15,000 euro të papaguara dhe si obligime, për në vitin në vijim. Për këtë arsye edhe shpenzimi në agjenci është qindpërqind në të gjitha kategoritë. Te shpenzimet e arsimit dhe trajnimeve, duke pasur parasysh mungesën e kapaciteteve të brendshme, ne kemi shfrytëzuar edhe IPA projektin përmes së cilit i kemi kryer trajnimet, kjo ka ndikuar edhe në nivelin e mosshpenzimit në këtë kategori. Sa i përket shpenzimeve intelektuale dhe këshillëdhënëse, agjencia funksionon si e pavarur dhe ne nuk kemi personelin e mjaftueshëm ashtu siç e përcakton ligjin për menaxhimin e financave publike. Si rezultat i kësaj gjendje, me qëllim të kryerjes së detyrave, në vitin 2012 dhe 2013 ne kemi bërë marrëveshje me Gjykatën Kushtetuese, zyrtarët e të cilës na kanë kryer procedurat e prokurimit dhe të tjera, me pagesë, mbështetur në rregullat e thesarit. Viti e kaluar kemi qenë në ministrin e punëve të jashtme dhe kjo ministri na ka kryer këtë shërbime.

Ilir Deda - a mundeni me na tregue se sa punëtor ju nevojiten juve për ti kryer këto detyra?

Bujar Sadiku - na nevojiten 9 persona për të kryer detyrat, ashtu siç parashihen me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Sipas rekomandimit të Komisionit Evropian, ne kemi nevojë për një ekspert në fushën e teknologjisë informative dhe këtë segment e kemi mbuluar në muajin tetor-nëntor, dhe e kjo ka ndikuar që pjesa e qasjes në të dhëna pikërisht teknologjisë informative, ka qenë një angazhim shtesë prej 500 apo 600 euro dhe që ka ngarkuar këtë pjesë të shërbimeve intelektuale e këshillëdhënëse.

Besa Gaxherri – mirëmbajtja e riparimeve të mjeteve është në shumë prej 5,000 euro, një sqarim?

Bujar Sadiku - Agjencia nga themelimi ka tërhequr vetura prej çdo institucioni për të mundur me e realizue planin e inspektimit në të gjithë republikën e Kosovës. Në këtë segment e kemi pas një veturë të cilën na ka falur Kuvendi si dhe në vitin 2011 kemi blerë dy vetura që i kemi pas në menaxhimin tonë dhe këto kanë krijuar shpenzime prej 5,000 euro.

Besa Gaxherri - sa kemi siguri në të dhënat tona personale, sepse është një çështje shumë e ndishme?

Ruzhdi Jashari - çështje e mbrojtjes së të dhënave personale është një çështje tepër delikate, në zhvillimin e hovshëm të teknologjisë informative. Shpresa numër një është që qytetarët e republikës së Kosovës e kanë një institucion që mund të adresojnë çështjet e shkeljes të dhënave personale e privatësisë së tyre. Ju keni parë procedurat në gjykata, raste që kanë filluar masat administrative ndaj atyre që shkelin të dhënat personale. Jemi partner i barabartë me vendet tjera të rajonit në këtë fushë, por kemi sfidat për ngritjen e kapaciteteve kadrovike.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Zyrës Rregullative për Energji për vitin 2014

Kryetari - në bazë të nenit 9 të Ligjit për rregullatorin e energjisë, kryesuesi i ZRRE-së, i ka dërguar Kuvendit raportin vjetor, i cili pasqyron buxhetin e miratuar për vitin 2014, si dhe të dhënat për shpenzimin e buxhetit, sipas kategorive e nënkategorive ekonomike, si dhe krahasimin me vitin paraprak. Por ashtu, raport mban të dhëna për të hyrat e realizuara. Buxheti përfundimtar i ZRRE-së ka qenë 573,291 euro, ndërsa është shpenzuar 539,519.12 apo shprehur në përqindje 94.11%.

Enver Halimi - buxheti i ZRRE-së për vitin 2014, ka qenë i miratuar në shumë prej 674,456 euro. Sipas kategorive ekonomike, për pagat e mëditjet janë shpenzuar 372,456, për mallra dhe shërbime 241,000, shpenzimet komunale 22,000, shpenzimet kapitale 40,000. Në ndërkohë kemi pasur dy shkurtime sipas vendimit të qeverisë, njeri ka qenë në vlerë prej 61,865 euro, shkurtimi i dytë është prej 39,400 euro. Në total, shuma e shpenzuar e mjeteve të ZRRE-së në vitin 2014 është 539,519.12 euro apo 94.11%, që është një përqindje e konsiderueshme.

Kryetari - për mua është një çështje shumë e rëndësishme me diskutue, që ZRRE, në një mbledhje më 24 qershor 2014, ka marrë vendim që për periudhën kohore prill-tetor të licencuarit të lirohen nga obligimi i pagesës së taksës vjetore prej 539,988.80 euro. Pyetja ime është, a është dashur që ZRRE të mjetet e inkasuar nga taksa e licencës, pjesën e mbetur pas ndarjes së të hyrave, të derdhë në buxhetin e Kosovës, që konsiderojë se kështu është dasht të ndodh, që është bërë edhe me institucionet tjera që realizojnë të hyra.

Enver Halimi – sqaroi se të hyrat nga taksat e inkasuar nga ZRRE në lidhje me licencimin, në bazë të nenit 44 të ligjit të rregullatorit të energjisë, neni 12, do të jenë të hyra të dedikuara. Kjo çështje po ashtu është e rregulluar edhe ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësit, përkatësisht neni 64.2 i këtij ligji që flet për financimin e institucioneve të pavarura. Bazuar në këto dispozita ligjore, ZRRE nuk mund të mbledhë të hyra për atë që janë nevojat e saj për përmbushjen e buxhetit vjetor. Pra

ne nuk kemi të drejtë të mbledhim më tepër mjete se sa janë nevojat e tona buxhetore. Por edhe në rast se mbledhim më shumë mjete atëherë e dëmtojmë konsumatorin tonë.

Kryetari – në buxhetin e ZRRE-së, a ka mjete të ndara edhe nga buxheti i Kosovës apo janë krejt mjete të dedikuara, si është e kalkuluar taksa e licencës?

Ejup Hasolli - zyra e rregullatorit, inkason dy lloj taksash vjetore. Sa i përket vendimit për lirim nga taksa, janë të liruar vetëm të licencuarit vetëm nga taksa vjetore. e jo nga taksa për shqyrtim të aplikacioneve, sepse ato janë shpenzime administrative. Taksa vjetore është e rregulluar nga bordi i ZRRE-së dhe për çdo megavat të prodhuar, gjegjësisht të importuar ZRRE inkason 0.22 cent. Meqë të hyrat e ZRRE-së janë të hyra të dedikuara, sikur të ishin mbledhur të gjitha të hyrat sipas shumës së taksës ne do të kishim tejkaluar buxhetin e aprovuar, prandaj është marrë vendimi për heqjen e taksës për një periudhë kohore për të licencuarit. Por, kjo është edhe në interes të mosngarkimit të konsumatorëve, që do të ndikojë në tarifat e konsumatorëve.

Kryetari - ju thatë se niveli i taksës për megavat të energjisë së prodhuar është 0.22 cent. Sa është detyrimi vjetor që duhet paguar bazuar në shifrën 0.22 cent, a keni bërë ndonjë kalkulim?

Ejup Hasolli – sqaroi se detyrimi vjetor për pagesën e taksës, varet nga konsumi. Në kohën kur është nxjerr vendimi në vitin 2010, është menduar të inkasohen rreth 1 milion euro, por kjo mundet me qenë plus apo minus, në varësi të konsumit. Për periudhën prill-tetor janë liruar elektranat që prodhojnë energji, si Kosova A dhe B, Ujmani dhe një elektranë në Junik. Po ashtu është liruar KEDS-i për energjinë të cilën e ka importuar.

Latif Gashi – në bazë të ligjit ju po thoni se nuk ka mundësi me pas tepëri të mjeteve, por nuk e keni marr pjesën tjetër të ligjit, e cila thotë në qoftë se institucion i juaji mbledhë mjet me shumë, e keni për obligim me i derdh në buxhetin e Kosovës. Pse nuk e keni bërë këtë?

Ejup Hasolli - me vet faktin se thuhet të hyrat e dedikuara, ZRRE inkason mjete për nevojat e saja buxhetore dhe nuk ka detyrim për buxhetin e Kosovës.

Kryetari – pse në mënyrë selektive është bërë kjo zbritje e taksës, pse nuk e keni zbrit tarifën në 0.22 në 0.8 %. Si është e mundur të lironi disa e disa jo, kush ua jep këtë të drejtë me veprue në mënyrë selektive?

Ejup hasolli – sqaroi se të gjithë të licencuarit janë të liruar.

Kryetari – është dashur të bëhen kalkulime më të sakta të pagesës së taksës që mbulon nevojat tuaja si të hyra të dedikuara dhe jo kështu të merret vendimi për mos pagesën e taksës.

Bali Muharremaj – ne ju kërkuam sqarim, ka me u debatua edhe në seancë dhe çmimi i energjisë elektrike është më i shtrenjti në Ballkan. Sipas mendimit tim, ky organ po veprojka çfarë po dojka, me çështjen e përcaktimit të taksës,

Enver Halimi – çmimi i energjisë në Kosovës nuk është më i shtrenjti, për këtë ka statistika dhe fakte të bërë nga ZRRE.

Enver Hoti – sa i përket raportit të auditorit të përgjithshëm lidhur me pasqyrat financiare, janë evidentuar mjaftë të gjetura. Çfarë masa keni ndërmarrë që të gjeturat e rekomandimet e auditorit të përgjithshëm të implementohen dhe nëse janë të përsëritshme nga viti në vit, a ka ndonjë ndryshim nga viti 2012 në vitin 2013 e tutje? Në një çështje tjetër është se si po arrini me i krye detyrat kur drejtori

menaxhues mungon? Pyetja tjetër është te humbjet që iu fakturohen qytetarëve, çfarë është bërë me humbjet komerciale e teknike? Çfarë ka bërë KEDS-i në investimet e veta me i zvogëlue humbjet në sistemin e distribuimit në vlera teknike, sa është vlera e këtyre humbjeve dhe e sa është e lejueshme prej ligjit?

Besa Gaxherri – në lidhje me mbledhjen e të hyrave, edhe pse nuk e kam konsultuar ligjin, logjika thotë se në rast se mblidhen mjete më shumë se sa i keni planifikuar, ato mjete duhet të derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Në rast se ligji nuk e parasheh kështu, unë mendoj se duhet me i bërë ndryshimet ligjore sepse këto gjëra nuk guxojnë me ndodh. Sa i përket shpenzimeve, mendoj se janë disa kategori që duhet të ofroni sqarime për mënyrën e shpenzimit të tyre. Nëse analizojmë shpenzimet e juaja, tek pagat edhe pse ka rënie në vitin 2014 nga viti 2013, janë shpenzuar 307,000 euro. Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare janë 9,000 euro, ndërkaq mëditjet e udhëtimit zyrtar 15,000 euro dhe akomodimi gjatë udhëtimit zyrtar 7,700 euro, si dhe shpenzimet të tjera të udhëtimit 2,487. Pra një shumë e madhe e mjete të shpenzuara për udhëtime zyrtare jashtë vendit, për të cilat kërkojë që ti arsyetoni. Shpenzimet e telefonisë mobile 7,730 euro dhe telefonisë fikse 1,425 euro, shpenzimet e arsimit e trajnimit 5,600 euro, shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse 5,960 euro. Shpenzimet për mobile për çdo vit, herë 2,000 e herë kah 3,000 euro, kështu i keni paraqit në raport. Për dreka zyrtar i keni 4,8000 euro, karburant për vetura 4,700 euro, mirëmbajtja e automjeteve 3,196 euro, por edhe keni blerë vetura të reja për 23,000 euro. Po ashtu shpenzimet për mirëmbajtjen e ndërtesave administrative 10,560 euro, mirëmbajtje higjienike 10,000. Po ashtu shpenzimet e teknologjisë informative janë prezantuar në dy shuma. Unë mendoj se duhet të ulen shpenzimet operative dhe duhet të shikohet aspekti ligjor në lidhje me financimin dhe të hyrat, ndërkaq performanca është objekt diskutimi në komisionin tjetër.

Ejup Hasolli – shpenzimet e teknologjisë informative në total janë 16,100 euro. Për shpenzimet e udhëtimit jashtë vendi, ZRRE është anëtare e Komisionit për Energji të Evropës Juglindore, që i ka 4 komisione që mbajnë katër takime të rregullta, që do të thotë se janë gjithsej 16 takime të cilat janë obligative që duhet të shikohet. Shpenzimet intelektuale e këshillëdhënëse po ashtu janë të lejuara.

Kryetari - zyra e rregullatorit për energjisë elektrike, duhet me pas një planifikim më të mirë buxhetor, për këtë keni pasur edhe rekomandim prej auditorit gjeneral, prandaj edhe kjo është një vërejtje që kërkohet të bëhen përmirësime në të ardhmen.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit unanimsisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2014.

5. Shqyrtimi i Raportit financiar i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2014

Kryetari - raporti vjetor financiar i agjencisë për ndihmë juridike falas është hartuar me sipas formularëve standard dhe pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar dhe janë pasqyruar në mënyrë analitike e të përmbledhur të gjitha shpenzimet sipas kategorive dhe nënkategorive. Gjithashtu janë paraqit krahasimet e shpenzimeve me vitin paraprak.

Bahrije Berisha – përkundër sfidave që është ballafaquar agjencia për ndihmë juridike falas, me shkurtimin e buxhetit të viti 2014, agjencia ka realizuar dy të arriturat thelbësore, njëri ndër to është aprovimi i planit strategjik 2015-2019, dhe dy rihapja zyrave rajonale për ndihmë juridike falas të financuar nga donacioni i Ambasadës Norvegjeze, që më herët janë financiar nga UNDP.

Ramadan Gashi - agjencia për ndihmë juridike falas është ballafaquar me sfidën e madhe buxhetore me rastin e shkurtimit me pozicionin mallra e shërbime 15% sipas vendimit të qeverisë, pasi që në pozicionin mallra e shërbim e kemi pozicionin për avokat që është specifik. Me strategjinë e miratuar, Agjencia planifikon shtrirje sepse kështu na obligon Kushtetuta, ku ndihma juridike duhet tu jipet gjithë qytetarëve. Aktualisht me 5 zyre regjionale që janë me buxhet të Kosovës, nuk ka kurfare mundësie me e mbulue të gjithë terrenin. Prandaj ne kemi planifikuar të jenë tetë zyre të shtrira në Kosovë, pra edhe dy zyre tjera regjionale dhe për këtë kërkohet të financohen nga buxheti i Kosovës.

Kryetari - sa është sipas kalkulimit të juaj buxhet i mjaftueshëm që me i mbulue këtë pjesën e avokatëve, është fjala për funksionalizim të zyreve?

Ramadan Gashi – sqaroi se kostoja është 23,000 euro për një zyre, që janë të punësuar tre zyrtar ligjor dhe një asistent. Janë gjitha shpenzimet përcjellëse për avokate për ato zyre që janë dikun rreth 5,000 euro. Ne e kemi një marrëveshje me Odën e Avokateve që ka të bëjë me angazhimin e avokatëve, që të kalojnë në zyrën për ndihmë juridike falas.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2014.

6. Te ndryshme

6.1. Kryetari – ne si grup punues e kemi diskutuar me Sekretarin dhe kam pas takim edhe me Kryetarin e Kuvendit, lidhur KASH-in e Kuvendit për tri vitet e ardhshme. Kemi ardhur në përfundim që të bëhet shtimi i numrit të të punësuarve edhe për 21 më tepër, për arsye të implemtimit të MSA-së dhe detyrave të Kuvendit në këtë proces, që do të thotë që numri i punësuarve edhe me 10 që janë paraparë nga administrata, për nevoja të ndryshme do të rriten brenda tri viteve në 32. Si rezultat i rritjes së numrit është shtuar buxheti për paga dhe mëditje për këta punëtor dhe për mallra dhe shërbime. MSA do të ndikoj edhe në vizita më të shpeshta në Bruksel dhe në shtete të ndryshme prandaj është rritë buxheti në 350,000 euro planifikimi për udhëtime zyrtare. Sa i përket projektit kapital Villa Gërmia, në bazë të një marrëveshje që pritet të realizohet nga Qeveria bashkë me Bankën Botërore dhe USAID, projekti është menduar të përfundojë me kusht që ai objekt të dedikohet për IT. Pra është fjala për shkollim, trajnim dhe zhvillim të IT-së, që kanë me qenë në shërbim të institucioneve të Republikës së Kosovës.

6.2. Kryetari - në planin e punës kemi paraparë hartimin e Ligjit për institucionet mikrofinanciare dhe unë sot kam menduar që ta krijojmë një grup punues, i cili ka me pas shumë punë, pasi që e dimë se kemi të bëjmë me një çështje problematike, kur dihet edhe fakti se Gjykata Kushtetuese i ka shfuqizuar dispozitat nga ligji i bankave që rregullojnë këtë veprimtari. Propozojë që grupi punues të përbëhet nga: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj dhe Enver Hoti. Gjithashtu edhe anëtarët tjerë të komisionit munden Në një mbledhje tjetër kemi me diskutuar këtë çështje për me pas një koncept se çfarë po bëjmë kur fillojmë me punue në hartimin e draftit. Do të bashkëpunojmë ngushtë me Bankën Qendrore. Në bazë të propozimit të kryetarit, Komisioni njëzëri vendosi që të krijojë grupin punues për hartimin e Projektligjit për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Safete Hadergjonaj dhe Enver Hoti.

6.3. Kryetari – në lidhje me çështjen e taksës së sigurimit të automjeteve të huaja që hyjnë në Kosovës, ne kemi bërë kërkesën KDI-së për një hulumtim legjislativ, e cila ka angazhuar ekspertin që besojë se do të përfundojë shpejtë analizën. Pra e kam ngritur këtë çështje dhe e kam përkrahjen e juaj, që do të

bisedojmë normalisht edhe me Bankën Qendrore dhe Byron e Sigurimeve dhe ideja është me heq këtë taksë apo me sjell në një minimum të shumës, varësisht edhe se çfarë thotë ligji. Jemi në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Diasporës për këtë çështje, po ashtu edhe me Kryeministrin është biseduar dhe së shpejti do të bëjmë një zgjidhje dhe do të jeni të informuar.

6.4. Informim lidhur me evaluimin e të projektit të GIZ-it nga ekspertet e misionit vlerësues dhe rekomandimet për projektin e ri në fazën e tretë në vazhdim

Alexandra Fehlinger - e kemi pas komisionin vlerësues nga Gjermania, ku me shumicën prej jush janë takuar edhe komisioni vlerësues i ka nxjerr dy objektiva. E para e kanë bërë vlerësimin për fazën 2013 deri në fund të këtij viti, në anën tjetër bazuar në gjetjet që i kanë bërë gjatë vlerësimit kanë bërë një përgatitje për një masë pasuese për periudhën 2016-2018. Kemi qenë me fat se na kanë vlerësuar si të suksesshëm, që për neve është ë mirëseardhur dhe shpresojmë që do të vazhdojmë në mënyrë të njëjtë në të ardhmen. Ana tjetër e vlerësimit ka qenë të vijnë me propozime se si dhe ku duhet të fokusohet projekti në të ardhmen dhe propozimi i tyre është se objektivi i projektit të jetë që sistemi i financave publike që jetë i fuqizuar sa i përket llogaridhënies edhe efikasitetit. Janë identifikuar tri fusha të intervenimit që duhet të fokusohemi.

E para është fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet komisioni për buxhet dhe financa edhe komisionit për mbikëqyrjen e financave publike, me akterët e brendshëm e të jashtëm. E dyta është përmirësimi i disponueshmërisë të të dhënave buxhetore, të kuptueshme për të gjithë akterët e financave publike, duke përfshirë edhe komisionet. E treta është përmirësimi i efikasitetit të administratës tatimore dhe marrëdhëniet e saj me qytetarët. Sa i përket objektivës së parë, kjo nënkupton që duhet të vazhdojmë në kuptimin e të dy komisioneve sa i përket mbikëqyrjes parlamentare dhe në këtë drejtim të shohim një metodologji të përbashkët e jo ti qasemi individualisht njërit komision apo tjetrit. Specifikisht i kanë cekur, si caktimi i raportuesve dhe zbatimi i planit të punës së komisioneve, që do të thotë se duhet të organizojmë workshope të përbashkëta në mes të dy komisioneve. Një tjetër aspekt që është përmendur është qasja apo ofrimi me qytetarët dhe këtij mund të hyjnë dëgjimet publike me ministrin e linjës apo edhe organizata e tjera, mirëpo edhe është cek edhe çështja e përdorimit më të mirë të informatave, siç janë raportet e ministrisë së financave apo edhe të auditorit të përgjithshëm. Përveç fuqizimit të kontrollit parlamentare është kërkuar që të punojmë me ministrinë e financave në zhvillimin e raporteve në përmbajtje dhe përmirësimin e këtyre raporteve. Objektiva e fundit që ka të bëjë me bashkëpunimin me administratën tatimore, aktiviteti kryesor është fokusi me një njësi që është quajtur zyra për gjoba dhe ndëshkime. Hapat e radhës janë procesverbalet që janë përgatitur nga workshopi, të cilat në emër të Kuvendit kërkesa është se të nënshkruhen nga Kryesia e Kuvendit, që është një procedurë standarde me të gjitha projektet që bëhen me partnerët e përfshirë. Nuk është gjithçka e fiksuar, tani është vetëm fillimi i procesit, e vlerësimi i gjetjeve, por disa kontrollera të cilësisë në proces që ndodhin. Më pastaj, propozim-projekti i dorëzohet ministrisë federale, i cila ka të drejtë të bëjë ndryshime dhe brenda vitit shpresojë të finalizohet projekti për fazën në vazhdim.

Mbledhja përfundoi në ora 13:38

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani